



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.325/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulamtuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulamtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.325/2017 e datës 21.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik LDK me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në afërsi të Qendrës së Votimit në shkollën fillore “Vëllezërit Aksiq” në Lipjan, ditën e zgjedhjeve me 22.10.2017, janë vendosur flamuj të subjektit politik LDK, (10-15 metra). Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1, pika b), të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi dhe një CD, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se nga fotografia dhe video CD-ja që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se

objekti për të cilin pretendohet se është shfrytëzuar si Qendër e Votimit në ditën e votimit, ka shërbyer për të votuar sepse nuk është konstatuar nga provat e lartpërmendura asnjë shenjë, të cilin objekt e identifikon si Qendër Votimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 115, 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL. Anr.325/2017 më datën 22.10.2017



**Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.